



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Junikut  
Opština Junik - Municipality of Junik



## KONTRATA


Titulli i tenderit: Për LOT I Furnizim me paisje dhe material shpenzues për mirëmbajtje

Për LOT II Furnizim me material higjienik

Numri i prokurimit: 636-20-5660-1-3-6

Numri i brendshëm: 636-20-024-136

Data: 25.11.2020



**Komuna e Junikut** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), e përfaqësuar nga U.D. Zyrtaria Përgjegjëse e Prokurimit, Florinda Kukalaj në njërën anë,

Dhe Operatori Ekonomik P.M Group SH.P.K (në vazhdim "Kontraktuesi"), me numër të regjistrimit të biznesit dhe numër fiskal 810846230 me adresë Rr. Anton Çeta, 10 000, Prishtinë, Kosovë, me numër kontaktues: 048-881-999 dhe email: shpkpmgroup@gmail.com e përfaqësuar nga Pashtrik Mustafa në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Numri i prokurimit	636	2	0	5	6	6	0	1	3	6
Numri i brendshëm	636	2	0	0	2	4	1	3	6	

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Për LOT II Furnizim me material higjienik

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 25.11.2020 dhe përfundon me 25.04.2020.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 5 muaj nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë Komuna Junik- Administrata Komunale.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

## **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

## **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 3,723.30€; Tremijë e shtatëqind e njëzet e tri euro e tridhjetë cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

## **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

## **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

## **Neni 7 Garancioni**

---

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

#### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### **Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Pejë- Dega në Deçan në pajtim me ligjin e Kosovës.

#### **Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

**Për Operatorin Ekonomik- PM Group sh.p.k**

**Për Autoritetin Kontraktues- Komuna Junik**

<b>Emri:</b>	Pashtrik Mustafa	<b>Emri:</b>	Florinda Kukalaj
<b>Pozita:</b>	Menaxher	<b>Pozita:</b>	U.D. Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	25.11.2020	<b>Data:</b>	25.11.2020
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

Specifikacioni për "Furnizim me material higjienik"

Nr	Lloji i materialit	Njësia	Sasia	njësi me TVSH (€)	totale me TVSH
1	Shampon dyshemeje 1 l i cilësisë së lartë.	Copë	382	0.55	210.1
2	Shampon për pastrimin e duarve duar 1 l	Copë	230	0.85	195.5
3	Shampon për pastrimin e enë 1 l	Copë	60	0.5	30
4	Detergjent 3 kg	Copë	17	2.1	35.7
5	Sprej për pastrimin e xhamave 750 ml	Copë	190	0.55	104.5
6	Vim të lëngët	Copë	40	0.7	28
7	Lecka pambuku me dimenzion 1.2x0.6 m për dysheme të shkollave me mekanizëm metalik	Copë	18	1.2	21.6
8	Thasë për mbeturina 90kg te zi	Komplet/rol	70	0.4	28
9	Thasë për mbeturina 120kg te zi	Komplet/rol	60	0.45	27
10	Dezinfektues me bazë acidi për tualet	Copë	188	0.8	150.4
11	Acid Klorhidrik (pako x 12 l)	Pako	62	5.5	341
12	Thasë për mbeturina 30 kg te verdhë (për shporta)	Komplet/rol	85	0.35	29.75
13	Fshesa plastike për gjama me krah pastrimi 25 cm ose më të madhe.	Copë	40	0.65	26
14	Lecka për pastrimin e bankave dhe gjamave	Komplet	150	0.5	75
15	Thasë për mbeturina 60 kg te zi	Komplet/rol	50	0.3	15
16	Fshesa standarte bashk me kacija plastike	Copë	15	1.5	22.5
17	Acid për tualete	Copë	48	0.45	21.6
18	Doreza higjienike 10	Copë	1200	0.06	72
19	Shampon pastrues për tualet	Copë	25	0.65	16.25
20	Thasë për mbeturina 60 kg te kalter	Komplet/rol	30	0.3	9
21	Fshesa të forta 60 cm për beton dhe trotuare	Copë	5	2.5	12.5
22	Troleksa gome të vegjel	komplet	80	0.45	36
23	Brusha plastike për pastrimin e ëc	Copë	30	0.6	18
24	Fshisa me Bisht te Gjate 1 km	Copë	15	0.8	12
25	Fshisa me Bisht te shkurtër 10 cm	Copë	35	0.65	22.75
26	Salveta letre Kuzhine	Copë	800	0.25	200
27	Acid për pastrim të kanalizimit	Copë	33	0.45	14.85

28	Xhokera për pastrimin e dyshemesë së bashku me kovën plastike me sistem për shtrydhje.	Copë	52	1.5	78
29	Dorëza plastike pako x 100 copa dimenzion 10.	pako	10	7	70
30	Sprej për insekte (Miza)	Copë	5	0.9	4.5
31	Salveta të pambukta 30x30 cm	Copë	10	0.3	3
32	Syngjera të vegjel per ene	Copë	40	0.05	2
33	Shporta për mbeturina 20 l.	Copë	40	2.8	112
34	Kofa të plastikës 25 l.	Copë	11	0.9	9.9
35	Sapuna për pastrimin e duarve.	Copë	100	0.15	15
36	Mbajtëse sapuni që vendoset në muri	Copë	15	1.5	22.5
37	Doreza një përdorimeshe dimenzion 10.	Komplet	2	7	14
38	Maska cilesie te mire	Copë	2500	0.15	375
39	Dezinfectues për duar antibakterial 750mm	Copë	270	2.5	675
40	Fshesa për marimanga me bisht 2 m të gjatë	Copë	22	1.2	26.4
41	Paloma letre higjienike( tualet) 1\10	Komplet	360	0.95	342
42	Mbajtëse plastike te letres higjienike	Copë	10	8.9	89
43	Leter higjienike role dimenzion standart për mbajtësen plastike nga pozicioni 42.	Copë	200		
				0.55	110
				<b>TOTALI</b>	<b>3,723.30</b>

